



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHETIT

N J O F T I M
PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR REGJISTRIM NË PROVIMIN E
SHETIT NË PROFESIONET E RREGULLUARA TË MJEKËSISË
SEZONI XXV

Për të gjithë kandidatët aplikantë për regjistrim në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mjekut, Farmacistit, Stomatologut, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Labororit dhe Logopedistit, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **5 – 16 Shkurt 2024**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania.

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

- Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*
- Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga UP-ja ose në mungesë të UP-së, nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*

** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*

- Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit.*

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, lutemi që pasi të zgjidhet shërbimi “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania, të zgjidhet opsioni “shtetas i huaj” dhe të plotësohen fushat e kërkuara.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia. Gjithashtu me anë të kodit unik të gjurmimit mund të gjurmohen në çdo kohë statusin e aplikimit.

Kalendari i zhvillimit të sezonit dhe orari i provimit për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al

Ju urojmë Suksese!